



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Kontabiliteti Financiar
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Mars 2018

Kontabiliteti Financiar

- Viti II-të, Semestri IV
- Departamenti : KF
- Statusi i lëndes : Obligative
- Javët mësimore: 15 [4 orë ligjerata, 8 orë ushtrime(4 grupe)]
- Mësimdhënëse: Prof.Ass.Dr. Fitim Deari
- Asistent: MSc.Valdrin Misiri
- Orari i ushtrimeve: E hene (G4 – ora 09:45 - 11:15 E4)
- (G3 – ora 13:15 - 14:45 CI)
- (G2 – ora 15:00 - 16:30 CI)
- Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 11:30 - 13:00 CI)


- E-mail: valdrin.misiri@unhz.eu
- Website: www.unhz.weebly.com

Hyrje

- Kontabiliteti është i rëndësishem në jetën tuaj personale, sidomos në qoftë se ju jeni menaxher apo pronar i një biznesi.
- Shumë njerëz, në jetën e përditshme, kontabilitetin e kuptojnë si një llogarimbajtje.
- Llogarimbajtja (book keeping) në fakt është një pjesë e procesit të kontabilitetit që ka të bëjë vetëm me regjistrimin e transaksioneve në librat e kontabilitetit.
- Ndryshe nga kjo, kontabiliteti është proces i identifikimit, regjistrimit, përmbledhjes dhe raportimit të informacionit ekonomik për marrjen e vendimeve.

Kontabiliteti

- Pra, kontabiliteti është proces i identifikimit, regjistrimit, përmbledhjes dhe raportimit të informacionit ekonomik për marrjen e vendimeve.
- Qellimi kryesor i kontabilitetit është që të sigurojë informata sa më cilësore që do të krijonin bazën për marrjen e vendimeve
- Dy degët kryesore të kontabilitetit janë:
 - ✓ Kontabiliteti financiar
 - ✓ Kontabiliteti i menaxhmentit



Kontabiliteti financiar dhe menaxhmentit

- Kontabiliteti financiar është fushë e kontabilitetit, qëllimi themelor i të cilit është përgatitja e pasqyrave financiare mbi bazën e rregullave të caktuara, sic është GAAP.
- Ku vlerësimi i pozites financiare më së miri operacionalizohet më së miri duke i përdorur analizat e pasqyrave financiare.
- Kontabiliteti i menaxhmentit është proces i përgatitjes, raportimit dhe interpretimit të informacionit llogaritar që u jepet marrësve të brendshëm të informatave.
- Pra kontabiliteti i menaxhmentit përdoret nga ana e menaxherëve për marrjen e vendimeve lidhur me: planifikimin operativ, kontrollin dhe menaxhimin e kostos

Pasqyrat Financiare

- Bilanci i gjendjes (pasqyra e pozicionit financiar)
- Bilanci i suksesit (pasqyra e të ardhurave)
- Pasqyra e rrjedhave të parasë (Cash Flow)
- Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar apo kapitalin e vet
- Politika kontabel dhe njoftimet shtesë (shtojcat)

Bilanci i gjendjes

- Bilanci raporton në formë të përmbledhur gjendjen e llogarive të pasurisë, kapitalit të vet dhe detyrimeve të biznesit në datën e ndërtimit të tij për një periudhë të caktuar kohore
- PASURIA = KAPITALI + DETYRIMET
- KAPTIALI = PASURIA – DETYRIMET
- Ekzistojnë dy modele të cilat zakonisht përdoren për prezentimin e bilancit të gjendjes:
 - ✓ Formati vertikal ose në formë raporti
 - ✓ Formati horizontal ose në formë të llogarisë T

Ndikimi i transaksioneve ne ekuacionin e bilancit

- Investimet fillestare ne biznes
- Pasuria
- Ndertesat 40.000 €
- Keshi 10.000 €

- Kapitali i vet dhe Detyrimet
- Kapitali i vet 20.000 €
- Deftesat e pagushme 30.000 €

Ndikimi i transaksioneve ne ekuacionin e bilancit

- Blerja e inventarit te mallit me afat pagese
- Me 7 Janar firma “Elkos” ka blere disa produkete prej firmes “Albi” ne Prishtine ne vlere prej 6.000€
- Shitjet e inventarit te mallit ne kesh
- Me 20 Janar firma “Shala” ka shitur lengje ne kesh ne vlere prej 4.000 €.

Ndikimi i transaksioneve ne ekuacionin e bilancit

- Pagesa e kestit te defteses se pagueshme(kreditit)
- Me 6 shkurt firma “Elkos” i ka paguar kestin e kreditit afatshkurter ndaj Bankes Ekonomike ne vlere prej 5.000
- Blerjet e inventarit te mallit ne kesh
- Me 11 shkurt ndermarrja “Elkos” ka blere produkte ushqimore ne kesh nga “Nestle” ne vlere prej 4.500€ .

Ndikimi i transaksioneve ne ekuacionin e bilancit

- Pagesa ndaj llogarise se pagueshme(furnitoreve)
- Me 14 Shkurt firma “Elkos” ka paguar detyrimin ndaj furnitorit “Albi” ne vlere prej 3500 € nepermjet nje deftest te pagueshme te marre ProCredit Bank
- Pagesa ne kesh ndaj LL/P
- Me 18 shkurt ndermarrja “Elkos” ka paguar ne kesh pjesen tjeter te detyrimit te mbetur ndaj furnitorit “Albi” ne vlere prej 2500 €

Shembull 1:

- Supozojme se firma “ Elkos “ me 31.12.2016 ka pasur këtë saldo në llogarinë e librit kryesor:
- Ndertestat 700.000 €
- Makineritë 200.000 €
- Pajisjet 100.000 €
- Inventari i mallit 100.000 €
- Blerësit (LL/A) 80.000 €
- Parapagimet 20.000 €
- Keshi 100.000 €
- Kapitali i kontribuar 900.000 €
- Kredi afatgjatë pagushem 200.000 €
- Furnitorët (LL/P) 120.000 €
- Tatimi në fitim i pagueshëm 60.000 €
- Pagat e pagushme 20.000 €

Shembull 2:

- Patundshmeritë 300.000 €
- Makineritë 150.000 €
- Investimet financiare 50.000 €
- LL/A 12.000 €
- Inventari i mallit (Stoqet) 28.000 €
- Parapagimet e sigurimeve 7.000 €
- Keshi 23.000 €
- Tërheqjet e pronarit 5.000 €
- Kapitali më 1 janar 2007 400.000 €
- Dëftesat e pagushme afatgjatë 85.000 €
- Qiraja kapitale e pagushme 21.400 €
- LL/P 20.000 €
- TVSH e pagushme 30.000 €
- Kamata e pagushme 5.000 €
- Fitimi neto 13.600 €

Pasqyra e të ardhurave (Balanci i suksesit)

- Pasqyra e të ardhurave raporton suksesin operativ të ndërmarrjes në datën e ndërtimit të saj për një periudhë të caktuar kohore. Pasqyra e të ardhurave ndryshe emërohet si bilanc i suksesit apo si pasqyrë e fitimit apo humbjes.
- Ekzistojnë dy lloje të të hyrave:
 - ✓ Operative (afariste)
 - ✓ Jooperative (financiare)
- Shpenzimet klasifikohen në dy lloje:
 - ✓ Shpenzime operative
 - ✓ Shpenzime jooperative (financiare)

Formatet e pasqyrës së të ardhurave

- Pasqyra e të ardhurave prezentohet sipas dy formateve:
 - ✓ Formati në shumë hapa
 - ✓ Formati në një hap
- Sipas formatit në shumë hapa pasqyra e të ardhurave raporton kategorinë e fitimit në disa nënkategori...
- Ndërsa formati në një hap, i pasqyres së të ardhurave, l grupon të gjitha të hyrat në pjesën e parë duke përfshirë të hyrat nga shitjet dhe të hyrat e tjera operative kurse në pjesën e dytë raportohen të gjitha shpenzimet, përfshirë koston e mallërave të shitur, shpenzimet operative dhe jooperative.
- Totali shpenzimeve zbritet nga totali i të hyrave dhe në fund të kësaj pasqyre raportohet fitimi ose humbja neto e periudhes.

Pasqyra e rrjedhave të parasë (cash flow)

- Qëllimi kryesor i pasqyrës së rrjedhave të parasë është sigurimi i informacionit për biznesin lidhur me aktivitetet që ndikojnë në hyrjet dhe daljet e parasë gjatë një periudhe fiskale.
- Pasqyra e rrjedhave të parasë përbëhet në tri aktivitete apo kategori kryesore:
 - a) Aktivitetet operative
 - b) Aktivitetet investuese
 - c) Aktivitetet financuese
- Përgaditja e pasqyres së cash flow-it bëhet në bazë të dy metodave:
 - a) Metodës direkte
 - b) Metodës indirekte

Cash flow = A.O + A.I + A.F

- Aktivitetet operative – janë të gjitha transaksionet që lidhen me aktivitetin primar të biznesit. Transaksionet e tilla janë prodhimi, blerjet e mallrave dhe shërbimeve si dhe shitjet dhe shpërndarja e tyre tek blerësit (klientët) etj.
- Aktivitetet investuese – janë të gjitha transaksionet që kanë të bëjnë me blerjen dhe shitjen e pasurisë afatgjatë
- Aktivitetet financuese – përfshijnë transaksionet e rrjedhave të parasë që lidhen me financimin e brendshëm dhe të jashtëm të biznesit që lidhen me emitimin e aksioneve, financimit përmes obligacioneve, huazimeve bankare dhe instrumenteve tjera të borxhit

Metoda direkte dhe indirekte

- Në metodën direkte netorrjedhat e keshit prej aktiviteteve operative maten si diferencë e hyrjeve dhe daljeve të keshit nga transaksionet operative primare sic janë p.sh. blerjet dhe shitjet e mallrave.
- Në metoden indirekte netorrjedhat e keshit prej aktiviteteve operative vlerësohen duke e rregulluar fitimin neto të periudhës me efektet e transaksioneve dhe kategorive që nuk janë të natyrës monetare.

SNK 7 – Cash Flow

- Pagesa e dividendes:A.O ose A.F
- Arketimi i dividendes:A.O ose A.I

- Shitja e aksioneve:A.F
- Riblerja e aksioneve:A.F

Sepse burimi i tyre eshte nga aktiviteti financues

Shembull:

- Le të supozojme se gjatë vitit 2015 tek firma “Migros” kanë ndodhur këto transaksione lidhur me arketimet dhe pagesat në kesh:
- Saldo e llogarise se keshit është 70.000 €
- Janë arkëtuar ne kesh 180.000 € nga blerësit(LL/A) për mallrat e shitur më parë
- Janë paguar 20.000 € për shpenzimet e pagave
- Janë paguar 5.000 € për shpenzimet të zyres
- Janë emituar 6.000 aksione të rregullta në kesh me vlerë të tregut 15 €
- Është paguar kryegjëja e kreditit të marrë ndaj bankës TEB në vlerë prej 20.000 €
- Janë blerë në kesh 800 aksione të rregullta prej aksionareve të vet nga 15 € per aksion
- Janë paguar 40.000 € për blerjen e makinerive
- Është paguar dividendi në kesh për aksionarët e vet në vlerë prej 25.000 €
- “Migros” ka investuar në blerjen e 3.000 aksioneve të rregullta të kompanisë tregtare “Albi Mall”. Ato janë blerë ne kesh 20 € për aksion
- Janë paguar 12.500 € për shpenzime të shërbimeve publike (rryme, uje, mbeturina)
- Janë arkëtuar 40.000 € në emer të shitjes se një lokali afarist dhe 20.000 € nga shitja e disa pajisjeve të punes.
- Janë paguar polisat e sigurimit të automjeteve prej 10.000 €
- Janë paguar 14.000 € për tatimin në të ardhurat e korporatave
- Janë arkëtuar 5.000 € nga provizionet (komisionet) e shitjes
- Janë pranuar në kesh 10.000 € në emer të dividendit për aksionet e blera nga “Albi Mall”

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar

- Pasqyra e kapitalit aksionar raporton informacionin për ndryshimet në gjendjen e kapitalit aksionar të kompanisë gjatë një periudhe fiskale.
- Në ndryshimet e shumës së kapitalit aksionar ndikojnë kryesisht emetimet e reja të aksioneve, blerja e aksioneve prej aksionarëve të vet
- Dy komponentet kryesore, përkatësisht burimet e kapitalit aksionar janë:
 - a) Kapitali i kontribuar dhe
 - b) Fitimi i mbajtur

Kapitali i kontribuar dhe fitimi i mbajtur

- Kapitali i kontribuar paraqet shumën e investuar në korporatë nga ana e pronarëve të saj. Pra, kapitali i kontribuar përfshin të gjitha aksionet në zotërim sipas vlerës nominale si dhe preminë në aksione.
- Kapitali i kontribuar rritet nga çdo emetim i ri i aksioneve, ndërsa zvogëlohet nga çdo riblerje e aksioneve prej aksionarëve të vet.
- Fitimi i mbajtur është shuma e fitimit neto të pashpërndarë për dividend, i cili mbahet për tu riinvestuar në korporatë.
- Fitimi i mbajtur rritet nga fitimi neto i periudhës, kurse zvogëlohet nga humbja neto e periudhës dhe nga deklaratimet e dividendit

Shembull:

- Problemi 2.3 – Faqe 87
- Problemi 2.5 – Faqe 88
- Problemi 2.6 – Faqe 89

Pyetje



Suksese!